

OPTIMA COMMUNICATION Sh.P.K.
NUIS K71903025A
Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 5/4
PASQYRA FINANCIARE 2017

**Pasqyrat financiare
dhe Shënimet Shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

OPTIMA COMMUNICATION Sh.P.K.
NUIS K71903025A
Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 5/4
PASQYRA FINANCIARE 2017

PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	5
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-18

Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

		Shënime	Më 31 dhjetor 2017	Më 31 dhjetor 2016
AKTIVET				
Aktive afatshkurtra				
Mjete monetare	4		1,331,394	2,984,484
Kërkesa për arkëtim tregtare	5		4,477,228	4,423,393
Kërkesa për arkëtim tatimore	6		871,982	871,982
Të tjera kërkesa për arkëtim	7		8,758,568	8,828,016
Inventarë	8		-	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9		279,000	279,000
Totali i aktiveve afatshkurtra			15,718,172	17,386,875
Aktive afatgjata				
Aktive afatgjata materiale	10		1,464,187	3,396,454
Totali i aktiveve afatgjata			1,464,187	3,396,454
Totali i aktiveve			17,182,359	20,783,329
DETYRIMET				
Detyrimet afatshkurtra				
Llogari të pagueshme tregtare	11		27,637	913,763
Detyrime Tatimore	12		90,369	450,638
Të tjera detyrime	13		290,000	110,000
Totali i detyrimeve afatshkurtra			408,006	1,474,401
Detyrimet afatgjata				
Detyrime financiare – afatgjata			-	-
Detyrime tatimore të shtyra			-	-
Totali i detyrimeve afatgjata			-	-
KAPITALI				
Kapitali i nënshkruar	14		100,000	100,000
Fitim /(Humbje) të mbartura	14		19,208,928	19,115,372
Fitim /(Humbje) e vitit	14		(2,534,575)	93,556
Totali i kapitalit			16,774,353	19,308,928
Totali i detyrimeve dhe kapitalit			17,182,359	20,783,329

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
I. Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	4,292,761	6,793,271
Totali të ardhurave (I)		4,292,761	6,793,271
II. Shpenzime			
Shpenzime të personelit	16	(2,988,108)	(1,086,554)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	17	(3,236,217)	(4,382,274)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	10	(404,103)	(899,855)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(108,328)	(205,077)
Totali i shpenzimeve (II)		(6,736,755)	(6,573,761)
Fitim Humbja nga veprimtarite kryesore (I+II)		(2,443,994)	219,510
III. Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura dhe shpenzime nga interesat	18	(341)	(262)
Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit	18	(31,640)	7,413
Komisione Banke	18	(58,600)	(55,826)
Të ardhura (shpenzime) financiare neto (III)		(90,581)	(48,675)
Fitimi para tatimit (I+II+III)		(2,534,575)	170,835
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	19	-	(77,279)
Fitimi (Humbja) e Vitit		(2,534,575)	93,556
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat e këmbimit në përkthimin e operacioneve të huaja		-	-
Fitim/(humbje) në rivlerësimin e pronës		-	-
Fitim/(humbje) në aktivet financiare të disponueshme për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve		-	-
Të ardhura të tjera totale gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Fitim/(humbje) i atribueshem për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		(2,534,575)	93,556
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Fitimi/(humbja) për vitin		(2,534,575)	93,556
Të ardhura/(humbje) totale të atribueshme për:			
Pronarët e shoqërise mëmë		(2,534,575)	93,556
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(2,534,575)	93,556

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyra e kapitalit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë shprehur në LEK)*

	Kapitali i regjistruar	Fitime të mbajtura	TOTAL
Balanca e hapjes			
			-
Më 01 Janar 2015	100,000	18,451,575	18,551,575
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	663,797	663,797
Shtim Kapitali		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000	19,115,372	19,215,372
Transferim ne reserve	-		-
Dividente të paguar	-		-
Më 31 Dhjetor 2015	100,000	19,115,372	19,215,372
Më 01 Janar 2016	100,000	19,115,372	19,215,372
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	93,556	93,556
Shtim Kapitali		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000	19,208,928	19,308,928
Transferim ne reserve	-		-
Dividente të paguar	-		-
Më 31 Dhjetor 2016	100,000	19,208,928	19,308,928
Më 01 Janar 2017	100,000	19,208,928	19,308,928
Fitimi/ (Humbja) e vitit	-	(2,534,575)	(2,534,575)
Shtim Kapitali		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	100,000	16,674,353	16,774,353
Transferim ne reserve	-		-
Dividente të paguar	-		-
Më 31 Dhjetor 2017	100,000	16,674,353	16,774,353

Shënimet shpjeguese në faqet 7 - 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e lëvizjes së mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë shprehur në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:		
Fitimi pas tatimit	(2,534,575)	93,556
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	404,103	899,855
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	(2,130,472)	993,412
Zvogëlimi / (ritja) e inventarëve	-	-
Zvogëlimi / (ritja) e kërkesave për arkëtim	15,614	(1,088,480)
(Zvogëlimi) / ritja e llogarive të pagueshme	(1,066,395)	(572,541)
	(3,181,253)	(667,609)
Interes i arkëtuar	-	-
Tatim fitimi i paguar	-	-
Paraja neto nga aktivitetet operative (I)	(3,181,253)	(667,609)
Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	1,528,163	-
Paraja neto nga aktivitetet investuese	1,528,163	-
Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:		
Arkëtime nga derdhja e kapitalit	-	-
Arkëtime nga huamarrjet dhe qiratë financiare	-	-
Arkëtime nga përdorimi i kredisë kufi	-	-
Paraja neto veprimtaritë financuese	-	-
Pakësimi neto i mjeteve monetare	(1,653,090)	(667,609)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	2,984,484	3,652,093
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	1,331,394	2,984,484

Shënimet shpjeguese në faqet 7-18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Administrator
Elton Rama

Elton Rama
[Signature]
COMMUNICATION
NIPT: K71903025A

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Optima Communication sh.p.k. (referuar si "Optima" ose "Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 26 dhjetor 2006.

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit 9901, datë 14 prill 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj. Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në ofrimin e shërbimeve grafike dizënjim, editori, dizënjim faqe web, grafike multimediale, fushata promovionale prodhimesh, fushata sociale, packaging, reklama, ilustrime, broshura, katalogje elektronike dhe aktivitete të tjera në fushën e grafike dizënjim. Shoqëria zotërohet 40 % nga ortakut Z. Glon Bakalli, 40 % nga ortakut Z. Ilir Daci dhe 20 % nga ortakut Z. Niko Qirici.

Vlera e kapitalit themeltar është 100.000 Lekë, e ndarë në 3 kuota me vlerë nominale respektivisht 40.000 lekë, 40.000 lekë dhe 20.000 lekë për kuotë. Administrator i Shoqërisë është Z. Elton Rama. Shoqëria disponon ambjente në Tiranë që ndodhen në Ibrahim Rugova, Sky Tower, 5/4.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 2 (dy).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Përputhshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura më datë 15 qershor 2006 në përputhje me Ligjin 9228, datë 29 prill 2004 të ndryshuar me ligjin 9477, datë 9 shkurt 2006, dhe të përmirësuara në përputhje me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.64, datë 22.07.2014, në fuqi nga data 1 janar 2015.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë. Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 janë paraqitur duke u nisur nga supozimi se Shoqëria do të jetë në gjendje t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë këto të drejta dhe detyrime gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabël kryesore

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në fillim dhe në fund të periudhës. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Euro/Lek	132.95	135.23
USD/Lek	111.10	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë joderivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa më poshtë. Për instrumentat e mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua me interes të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiare klasifikohen si asete afashkurtra me përjashtim të rasteve kur shoqëria ka një të drejtë pa kusht për ta shtyrë pagesën e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normës së interesit e cila i përafrohet normës së tregut.

3.3 Aktive të qëndrueshme jomateriale

Aktivet e qëndrueshme jomateriale që kanë një jetë të përcaktuar maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi koston e blerjes së aktivit e zvogëluar me vlerën e tij të mbetur. Shuma e amortizimit kalon në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë jetës së aktivit.

3.4 Aktive të qëndrueshme materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin, nëse ka, dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Kostot e mëposhme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga data e vënies në përdorim. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti e të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.5 Zhvlerësimi

Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitetet jofinanciare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ekzistojnë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlera e rikuperueshme vlerësohet.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë së gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe pensione

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond social të menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqëria njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Njohja e të ardhurave

Shitja e shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.9 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare, huatë e dhëna dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Administrator
Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***4. MJETET MONETARE**

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari rrjedhëse dhe arkë:		
Leke	1,329,579	2,963,629
Euro	1,815	20,855
TOTALI	1,331,394	2,984,484

5. KËRKESA PËR ARKËTIM TREGTARE

Kërkesat e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klientë	4,477,228	4,423,393
TOTALI	4,477,228	4,423,393

6. KËRKESA PËR ARKËTIM TATIMORE

Kërkesat e arkëtueshme tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim - fitimi	871,982	871,982
TOTALI	871,982	871,982

7. TË TJERA PËR ARKËTIM

Kërkesat e tjera për arkëtim më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kërkesa të tjera për arkëtim	8,758,568	8,828,016
TOTALI	8,758,568	8,828,016

8. INVENTARË

Shoqëria nuk ka inventar gjëndje më 31.12.2017.

9. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Garanci	279,000	279,000
TOTALI	279,000	279,000

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë në LËK, përveç kur shprehet ndryshe)***10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Pajisje zyre, moblie	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali i Aktiveve
AQT me kosto historike				
Teprica më 1 Janar, 2017	1,162,652	2,998,282	5,050,321	9,211,255
Shtesa nga blerjet				
Pakësime nga shitjet			(3,197,885)	(3,197,885)
Teprica më 31 Dhjetor, 2017	1,162,652	2,998,282	1,852,436	6,013,369
Amortizimi akumuluar				
Teprica me 1 Janar, 2017	(736,149)	(2,389,382)	(2,689,270)	(5,814,801)
Shtesa e vitit	(85,301)	(152,225)	(166,577)	(404,103)
Pakësime të vitit	-		1,669,722	1,669,722
Teprica më 31 Dhjetor, 2017	(821,450)	(2,541,606)	(1,186,125)	(4,549,182)
Balanca më 31 Dhjetor, 2017	341,202	456,675	666,310	1,464,187

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë	27,637	913,763
TOTALI	27,637	913,763

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim mbi të ardhurat personale	29,881	29,785
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	41,219	30,816
TVSH	19,269	390,037
TOTALI	90,369	450,638

13. TË TJERA DETYRIME

Teprica e zerit të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	290,000	110,000
TOTALI	290,000	110,000

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***14. KAPITALI I NËNSHKRUAR**

Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kapitali	100,000	100,000
TOTALI	100,000	100,000

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat e shoqërisë gjatë vitit 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shërbimi	4,292,761	6,793,271
TOTALI	4,292,761	6,793,271

16. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve gjatë vitit 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e personelit	2,729,458	870,614
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	258,650	215,940
TOTALI	2,988,108	1,086,554

17. SHPENZIME TË PERGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative gjatë vitit 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shërbime printi	940,917	2,201,483
Shërbime noteriale	13,314	13,000
Shërbime Design	777,300	1,023,500
Shërbim realizim spoti	1,192,600	-
Transferime, udhetime, dieta	99,658	-
Blerje online	111,009	-
Hostim domain	-	7,479
Shpenzime kreative	-	1,023,500
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	101,419	113,312
Shpenzime të tjera	108,328	205,077
TOTALI	3,344,545	4,587,351

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***18. TE ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE**

Të ardhurat (shpenzimet) financiare gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesa bankare	164	157
Shpenzime për interesa	(506)	(419)
	(341)	(262)
Fitime të realizuara nga kursi këmbimit	28,654	49,997
Humbje të realizuara nga kursi këmbimit	(60,294)	(42,584)
	(31,640)	7,413
Komisione bankare	(58,600)	(55,826)
TOTALI	(90,581)	(48,675)

19. TATIM FITIMI

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje përveç nëse lidhet me zera të njohur direkt në kapital, rast në të cilin njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshem për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me kërkesat e SKK dhe vlerave të njohura të ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi (humbja) e vitit	(2,534,575)	170,835
Rregullime për zëra shpenzimesh të panjohura:	438,982	344,358
Fitimi (humbja) fiskale e vitit	(2,095,593)	515,193
Shpenzimi aktual për tatim fitim 2017	-	(77,279)
Fitimi (humbja) fiskale e vitit neto	(2,095,593)	437,914
Gjendje kreditore e mbartur	871,982	949,261
Balanca TF për vitin pasardhës	871,982	871,982

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15 % për vitin 2017 (2016: 15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të adhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe bëjnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritet tatimore. Për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal.

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017, Shoqëria nuk ka detyrim tatim fitimi për të paguar.

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan nga Drejtimi i Shoqërisë më 15, Mars 2018:

Administrator
Elton Rama



Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***Shoqëria Optima Communication Sh.p.k.****NIPT K71903025A****Aktivet Afatgjata Materiale me vlerë fillestare 2017**

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2017
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makineri,paisje Instalime	2,397,418			2,397,418
4	Mjete transporti	5,050,321		3,197,885	1,852,436
5	Mobilje Orendi	1,162,652			1,162,652
6	Paisje Infomatike	600,864			600,864
TOTALI		9,211,255	-	3,197,885.40	6,013,369

Amortizimi A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2017
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makineri,paisje Instalime	2,020,788	94,157		2,114,946
4	Mjete transporti	2,689,270	166,577	1,669,722	1,186,125
5	Mobilje Orendi	736,149	85,301		821,450
6	Paisje Infomatike	368,593	58,067		426,660
TOTALI		5,814,801	404,103	1,669,722.40	4,549,181

Vlera Kontabël Neto e A.A.Materiale 2017

Nr	Emertimi	Gjendje 01/01/2017	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2017
1	Toka				
2	Ndërtime				
3	Makineri,paisje Instalime	376,630	94,157		282,472
4	Mjete transporti	2,361,051	166,577	1,528,163	666,310
5	Mobilje Orendi	426,503	85,301		341,202
6	Paisje Infomatike	232,270	58,067		174,202
TOTALI		3,396,453	404,103	1,528,163.00	1,464,187

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Shoqëria Optima Communication Sh.p.k.
NIPT K71903025A

Inventari automjeteve në pronesi të subjektit
31.12.2017

Nr.	Lloji automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera e mbetur
1	Hyundai I10	4+1	AA738FP	383,219
2	Hyundai I10	4+1	AA413AP	283,090
Shuma				666,310

Inventari në pronesi te subjektit
31.12.2017

Nr.	Lloji i mallit	Cope	Cmim	Vlera
Shuma				-

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë, më 15 Mars 2018.

Administrator
Elton Rama

